




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 46 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit , 01.Nr.016-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet 01. 016-28448 të datës 22.03.2018, nenin 11 të Rregullores për punën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit 01.nr.16-53246 të datës 13.06.2013, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 26.02.2026, merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR VITIN 2026

1. Me këtë vendim themelohet Grupi punues për hartimin e Planit vjetor të punës për vitin 2026 të Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Grupi punues ka këtë përbërje:

- 1.1 Krenare Latifi Kqiku, Kryesues
- 1.2 Shpend Nuhiu
- 1.3 Sami Ahmeti
- 1.4 Liresë Kosumi
- 1.5 Ali Selimi

2. Grupi punues si në pikën 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe shoqërinë civile, harton Draftin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin kalendarik 2026 dhe të njëjtin e paraqet para Kuvendit të Komunës për miratim.
3. Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbajë: objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe funksionale të Kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara si dhe koston financiare për implementimin e Planit të punës.
4. Plani i punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e Kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web faqen e Komunës.

01.Nr.016-15271/26
Gjilan, më 26.02.2026



Kryesuesja e Kuvendit,
Krenare Latifi Kqiku
Krenare Latifi Kqiku/